

FJALORTH

PËR GJUHËN GJITHËPËRFSHIRËSE NDAJ PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

TIRANË, SHTATOR 2024



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

*Ky botim u prodhuan me mbështetjen
financiare të Bashkimit Evropian dhe
të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij
është përgjegjësi vetëm e autorit(ve).
Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund
të konsiderohen në asnjë mënyrë se
pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit
Evropian apo të Këshillit të Evropës.*

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve
(deri në 500 fjalë), me përjashtim të
riprodhimit për qëllime tregtare për
sa kohë që ruhet integriteti i tekstit,
fragmentet nuk përdoren jashtë
kontekstit, nuk jepen informacione
të paplotë dhe nuk e keqorientojnë
lexuesin sa i përket natyrës,
fushëveprimit apo përmbajtjes së
tekstit. Teksti burimor duhet të njihet
gjithmonë si vijon “© Këshilli i Evropës,
viti i botimit”.

Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje
me riprodhimin/përkthimin e të
gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve
të dokumentit duhet t’i drejtohen
Departamentin e Anti-diskriminimit
Drejtoria e Përgjithshme e Demokracisë
dhe Dinjitetit Njerëzor Njësia Kundër
Gjuhës së Urrejtjes dhe Bashkëpunimit,
Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg
Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera
në lidhje me këtë publikim duhet t’i
drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve,
Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg
Cedex ose publishing@coe.int).

© Këshilli i Evropës, Shtator 2024. Të
gjitha të drejtat e rezervuara. Licencuar
për Bashkimin Evropian sipas kushteve
të caktuara.

FJALORTH
për gjuhën gjithëpërfshirëse
ndaj personave me aftësi të kufizuara

Tiranë, shtator 2024



Ky Fjalorth u realizua nga:
Fondacioni "Se Bashku"
<https://sebashku.org/>

Treguesi i lëndës:

Hyrje	6
Lista e koncepteve terminologjike të përfshira në Fjalorth 7	
Fjalorth shpjegues	8
Shtojcë: Parime të përgjithshme mbi gjuhën që duhet përdorur me dhe për personat me aftësi të kufizuara	17
Tabelë përmbledhëse e terminologjisë së rekomanduar dhe terminologjisë së gabuar	19

Hyrje

Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës që nga korriku i vitit 1995¹, duke u angazhuar në këtë mënyrë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe për të punuar në drejtim të përfshirjes sociale, ndër çështje të tjera të rëndësishme. Pothuajse 30 vjet më vonë, Shqipëria është më afër se kurrë anëtarësimit në Bashkimin Evropian² dhe si rrjedhojë legjislacioni ynë gradualisht po përafrohet me atë të BE-së. Ky angazhim vlen edhe në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Në vitin 2011³, vetë Bashkimi Evropian, për herë të parë në histori ratifikoi Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si një entitet sui generis, duke u bërë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Konventës, në fushat brenda juridiksionit të vet. Që atëherë, shumë rregullore dhe direktiva të BE-së, janë miratuar si rezultat i Konventës, si Akti i Aksesueshmërisë dhe gjithashtu Strategjia e BE-së për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2030 është miratuar me qëllim zbatimin e dispozitave të Konventës. Të gjitha vendet anëtare të BE-së e kanë ratifikuar Konventën.

Në vitin 2013 Shqipëria miratoi Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila solli një ndryshim paradigme në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke theksuar rëndësinë e qasjes bazuar në të drejtat e njeriut për personat me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, ne shpesh vërejmë në diskursin publik nga zyrtarë shtetërorë, përfaqësues të mediave dhe profesionistë të tjerë apo në faqet zyrtare të internetit ose dokumentet zyrtare, përdorimin e një qasjeje të vjetëruar ndaj aftësisë së kufizuar dhe terminologji që nuk bazohet në respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut.

Për të mbushur këtë boshllëk në komunikim me dhe për personat me aftësi të kufizuara dhe për të promovuar një gjuhë gjithëpërfshirëse që respekton diversitetin, është hartuar ky FJALORTH për gjuhën gjithëpërfshirëse ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Materiali përbën interes për t'u lexuar dhe për t'u zbatuar në praktikë, veçanërisht, prej punonjësve dhe drejtuesve të të gjitha institucioneve shqiptare në nivel qendror dhe vendor, si prej institucioneve shtetërore, ashtu edhe prej atyre private. Ky Fjalorth u vjen në ndihmë, po ashtu, punonjësve të mediave të shkruara dhe vizive, si një manual orientues për komunikimin etik dhe për raportimin mediatik profesional, të bazuar mbi dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.

Ky fjalorth terminologjik është bazuar në:

- Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁴ dhe në Komentet e përgjithshme⁵ të Komitetit mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁶ dhe vendimet⁷ e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me aftësinë e kufizuar
- Strategjia e BE-së për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2030⁸
- Broshurën "Disability-inclusive language guidelines"⁹ ("Udhëzime për gjuhën gjithëpërfshirëse ndaj personave me aftësi të kufizuara")

1 <https://puneteshqiptare.al/en/keshilli-i-evropes-dhe-shqipëria/>

2 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/albania_en

3 https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_11_4

4 <https://www.un.org/disabilities/documents/convention/convoptprot-e.pdf>

5 <https://www.ohchr.org/en/treaty-bodies/crpd/general-comments>

6 https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Convention_ENG

7 https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Disabled_ENG

8 <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1484&langId=en>

9 <https://www.ungeneva.org/sites/default/files/2021-01/Disability-Inclusive-Language-Guidelines.pdf>

Lista e koncepteve terminologjike të përfshira në Fjalorth:

Akses (Qasje) – Aksesueshmëri (QASSHMËRI)

Akomodim i Arsyeshëm

Aksesueshmëri vs Akomodim i arsyeshëm

Arsimi gjithëpërfshirës

Asistenca Personale

Asistenti Personal

Brajl (Braille)

Deklarimi ose fshehja e aftësisë së kufizuar

Dëmtim vs Aftësi e Kufizuar

Dëmtim shikimi vs Verbëri

Ejbëllizëm (Ableism)

Gjuha e Shenjave dhe Shenjat Ndërkombëtare

Gjuhë e Thjeshtë

Integrim vs Gjithëpërfshirje

Jetesa e Pavarur

Kafshë shërbimi

Ndihmë, Mbështetje, Asistencë

Nevojat vs Kërkesat

Organizata e/për Personave/t me Aftësi të Kufizuara

Person me aftësi të kufizuara

PWD (shkurtesa e termit: Personat me Aftësi të Kufizuara)

Përshkrimet video

Vendimmarrje e mbështetur

Fjalorth shpjegues

AKSES (QASJE) – AKSESUESHMËRI (QASSHMËRI)

AKSES (em.)^{10*} - nënkupton mundësinë ose të drejtën për të bërë diçka, për të hyrë në një vend, apo për të marrë një shërbim. Për shembull, ju mund të keni të drejtën të hyni në një muze, sepse është i hapur falas për publikun. Kjo do të thotë që keni akses, ose qasje për të hyrë brenda ndërtesës së muzeut.

AKSESUESHMËRIA (Qasshmëria) (em.) - i referohet dizajnit dhe organizimit të produkteve, pajisjeve, shërbimeve apo mjediseve në një mënyrë të tillë që t'u mundësojë përdorimin e tyre të gjithë personave, përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara. Kjo nënkupton gjithashtu edhe qasjen në informacion dhe komunikim. Për shembull, aksesueshmëria fizike nënkupton krijimin e një mjedisi pa barrierë fizike, ku personat me aftësi të kufizuara mund të lëvizin dhe të përdorin hapësirat lirshëm.

Duke marrë shembullin e mësipërm, mund të keni qasje për të hyrë në një muze, por nëse ndërtesa nuk ka rampa për personat përdorues të karrigeve me rrota, nuk ka ashensorë dhe nuk ka sinjalistikë të sistemit Brajl për personat me aftësi të kufizuara në shikim, atëherë hyrja në muze nuk mund të realizohet dhe kjo ndërtesë nuk është e qasshme për të gjithë njerëzit.

Po ashtu, e njëjta logjikë vlen edhe për hapësirat virtuale. Për shembull, një faqe interneti mund të jetë e hapur për të gjithë dhe mund të aksesohet nga çdo pajisje me lidhje interneti. Kjo nënkupton se ne kemi qasje në njohjen e përmbajtjes së saj.

Nëse faqja e internetit është e përshtatur për personat me aftësi të kufizuara, për shembull, duke pasur tekst alternativ për imazhet, mundësi për zmadhim të tekstit, sistem shkrimi Brajl dhe formatin e gjuhës së thjeshtë, atëherë ajo është e qasshme për të gjithë përdoruesit.

Në shumë raste, aksesimi mund të jetë i siguar, por aksesueshmëria mungon, prandaj këto terma nuk janë të njëjta dhe duhet të përdoren në kontekstin e duhur.

AKOMODIM I ARSYESHËM

(tf.) – Modifikim, ose përshtatje e nevojshme, që u krijon mundësinë personave me aftësi të kufizuara të përfshihen në veprimtarinë jetësore dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në rrafsh më konkret, termi “Akomodim i arsyeshëm” ose në variantin sinonimik, “Përshtatje e arsyeshme”, nënkupton çdo modifikim që bëhet në një proces pune, ose në përgjithësi në ambientin e punës, modifikim i cili do t'i mundësojë një punonjësi me aftësi të kufizuara të përfshihet dhe të kryejë të gjitha funksionet thelbësore të punës. Pra, përshtatja kryhet për të garantuar që një individ me aftësi të kufizuara të ketë mundësi punësimi të barabarta me ato të punonjësve të tjerë pa aftësi të kufizuara. Koncepti i akomodimit të arsyeshëm vlen edhe për fusha të tjera, si arsimi, të mirat dhe shërbimet etj.

Aksesueshmëri (Qasshmëri) vs Akomodim i arsyeshëm

“Aksesueshmëria” lidhet me mundësinë e gjithëpërfshirjes për të gjitha grupet, ndërsa **“Akomodimi i arsyeshëm”** lidhet me rastet specifike të individëve. Kjo do të thotë se “aksesueshmëria” i referohet nevojës për të siguar që mjediset, shërbimet, produktet dhe informacioni të jenë të arritshëm për të gjithë, duke përfshirë grupet e ndryshme të njerëzve, pra edhe ata me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria ka të bëjë me krijimin e standardeve që sigurojnë se të gjithë mund të përdorin një

10 * Duke qenë se materiali paraqitet në trajtën e *Fjalorit shpjegues* janë shënuar edhe kategoritë gramatikore të termave, duke përdorur shkurtesat e tipit: Em. – Emër; Tf. – togfjalësh etj.

hapësirë, ose shërbim pa pengesa. Kjo është një detyrë që duhet të kryhet paraprakisht (ex ante). Për këtë arsye, shtetet duhet të zhvillojnë standarde të aksesueshmërisë në bashkëpunim me organizatat e personave me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, ka raste kur këto standarde të qasshmërisë mund të mos jenë të mjaftueshme për individë që kanë nevoja më specifike. Për shembull, një person që nuk lexon sistemin e shkrimit Brail mund të mos përfitojë nga një shërbim që ofron vetëm këtë lloj qasjeje për personat e verbër. Në këto situata, është e nevojshme të zbatohet “akomodimi i arsyeshëm”.

“Akomodimi i arsyeshëm” i referohet ndryshimeve, ose rregullimeve që bëhen për të siguruar që një individ me aftësi të kufizuara të mund të ketë të njëjtin nivel qasjeje dhe mundësie si të tjerët. Kjo është një detyrë që zbatohet nga momenti kur individit i duhet (ex nunc), për shembull, kur një person me aftësi të kufizuara fillon një punë të re, ose ndjek një shkollë. Ndryshe nga aksesueshmëria, detyrimi për të siguruar “akomodim të arsyeshëm” ekziston vetëm nëse kjo nuk përbën një barrë të tepruar për subjektin që duhet ta ofrojë atë. Për shembull, një kompani mund të jetë e detyruar të bëjë ndryshime në vendin e punës për të akomoduar një punonjës me aftësi të kufizuara, por këto ndryshime bëhen nëse nuk janë shumë të kushtueshme ose të vështira për t’u zbatuar.

Kjo do të thotë se ndërsa shtetet dhe organizatat duhet të përpiqen të sigurojnë aksesueshmëri për të gjithë, akomodimi i arsyeshëm është një masë që merret në situata specifike për të siguruar që individët të kenë mundësi të barabarta, edhe kur standardet e përgjithshme të qasshmërisë nuk janë të mjaftueshme.

Arsim gjithëpërfshirës

Arsim gjithëpërfshirës (tf.) - Ekzistojnë katër konotacione kuptimore për këtë togfjalësh:

1. Një e drejtë themelore e të gjithë fëmijëve. Kjo do të thotë, që arsimi është një e drejtë individuale e zgjedhjes në bazë të dëshirave dhe preferencave të çdo fëmije dhe jo, ndërhyrje apo vendimmarrja nga prindi apo kujdestari. Roli i prindit është ta mbështesë fëmijën në marrjen e arsimit që i shërben më mirë kërkesave dhe të drejtave të fëmijës, edhe nëse kjo ndryshon nga preferencat e tij si prind;
2. Një parim që vlerëson mirëqenien e të gjithë nxënësve, respekton dinjitetin dhe autonominë e tyre, dhe merr parasysh kërkesat dhe aftësitë e individëve për t’u përfshirë në mënyrë efektive dhe për të kontribuar në shoqëri;
3. Një mjet për realizimin e të drejtave të tjera të njeriut. Arsimimi është mjeti kryesor, përmes të cilit, personat me aftësi të kufizuara mund të dalin nga varfëria, të përfshihen plotësisht në komunitetin rrethues dhe të mbrohen nga shfrytëzimi. Gjithashtu, shkollimi është mjeti kryesor për të arritur stadin e një shoqërie gjithëpërfshirëse;
4. Një proces angazhimi i vazhdueshëm dhe proaktiv nga ana e drejtuesve të shkollave për të eliminuar vështirësitë që pengojnë të drejtën për arsimim, së bashku me të gjitha masat që ndërmerren për ndryshimet në mënyrën e trajtimit, politikat drejtuese dhe masat praktike të shkollave për të akomoduar dhe përfshirë në mënyrë efektive të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që, çdo shkollë, pasi pranon rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës, fillon të marrë masa për të shmangur pengesat, për shembull, instalohen rampa ose ashensorë, trajnohen mësuesit se si të mbështesin nxënësit me aftësi të kufizuara, si dhe rishikojnë politikat e tyre për të siguruar që çdo nxënës, pavarësisht nga gjendja apo aftësia e kufizuar, të mund të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet shkollore. Me kalimin e kohës, këto ndryshime krijojnë një mjedis, në të cilin përfshihen të gjithë nxënësit në mënyrë efektive dhe reduktohen pengesat për arsimim.

AsistEnca personale

Asistenca Personale (tf.) i referohet mbështetjes njerëzore që ofrohet, si një formë që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë në mënyrë të pavarur. Edhe pse mënyrat e Asistencës Personale mund të ndryshojnë, ekzistojnë disa karakteristika që e dallojnë atë:

1. Financimi për Asistencën Personale duhet të bazohet në kritere të personalizuar dhe të respektojë standardet e të drejtave të njeriut për një punësim të dinjitetshëm. Ky financim duhet të menaxhohet dhe t'i alokohet vetë personit me aftësi të kufizuara, me qëllim që të paguajë për çdo mbështetje të nevojshme. Financimi duhet të bazohet në një vlerësim të nevojave të individit dhe në rrethanat e jetës së tij. Ky financim ndjek përdoruesin, jo ofruesin, dhe duhet të jetë në nivelin e tregut për të mundësuar punësimin e asistentëve në tregun e hapur të punës dhe jo ndër familjarë;
2. Shërbimi duhet të kontrollohet nga personi me aftësi të kufizuara. Ky individ mund të zgjedhë të kontrakttojë shërbimin e Asistencës nga disa ofrues të ndryshëm, ose të veprojë si punëdhënës. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën ta krijojnë shërbimin sipas dëshirës së tyre, duke përcaktuar kush, si, kur, ku dhe në çfarë mënyre ofrohet shërbimi dhe duke udhëzuar dhe drejtuar ofruesit e shërbimit;
3. Asistenca Personale është një marrëdhënie “një për një”. Ndihmësit personalë duhet të rekrutohen, trajnohen dhe mbikëqyren nga vetë personi që merr Asistencën Personale. Ndihmësit personalë nuk duhet të “ndahen” me individë të tjerë.
4. Vetëmenaxhimi i ofrimit të shërbimeve. Personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë Asistencë Personale mund të zgjedhin nivelin e kontrollit personal mbi mënyrën sesi ofrohet shërbimi, sipas rrethanave dhe preferencave të tyre. Edhe nëse disa përgjegjësi të “punëdhënësit” janë kontraktuar nga jashtë, personi me aftësi të kufizuara mbetet gjithmonë në qendër të vendimmarrjes për Asistencën që merr, dhe çdo kërkesë duhet të drejtohet tek ai. Preferencat individuale duhet të respektohen, dhe kontrolli mbi Asistencën Personale mund të ushtrohet përmes vendimmarrjes së mbështetur.

AsistEnti personal

Asistenti Personal (tf.) ofron asistencën personale për personat me aftësi të kufizuara.

Asistenti Personal mbështet personin me aftësi të kufizuara në shtëpi dhe në komunitet duke i mundësuar të jetojë i pavarur. Ky pozicion pune mund të përfshijë: mbështetjen e personit me aftësi të kufizuara në arsim, punësim dhe aktivitete sociale, asistencë për kujdesin personal, asistencë me detyra praktike dhe lëvizje në shtëpi dhe jashtë në komunitet.

BRILI (BRAILLE)

Brail (em.) - Sistem i pikave të ngritura që mund të lexohet me gishta, i cili përdoret nga njerëzit që janë të verbër, ose që e kanë të dobët shqisën e të parit.

Termi “Braille” vjen nga emri i shpikësit, Luis Brail (Louis Braille), i cili ishte një francez që krijoi sistemin e këtij shkrimi, në fillim të shekullit të 19-të.

Sistemin e shkrimit Braille nuk mund ta lexojnë të gjithë njerëzit e verbër. Çdokush ka aftësinë për të mësuar të lexojë përmes Brailit, kështu që kurrë nuk duhet të supozoni se një përdorues i Brailit është domosdoshmërisht edhe i verbër. Ata që mund të lexojnë Brail, quhen “përdorues të Brailit”. Procesi i konvertimit të tekstit të shtypur në Brail, quhet “transkriptim” (jo “përkthim”). Procesi i “shtypjes”, quhet “shtypje me sistem pikëzimi”. Për shembull, imagjinoni një libër të shkruar në anglisht, i cili duhet të jetë i qasshëm edhe për një lexues të verbër. Në vend që të përkthehet libri në një gjuhë

tjetër, një transkriptues i Brailit e shndërron tekstin në sistemin e simboleve të Brailit. Ky proces quhet “transkriptim” sepse gjuha mbetet e njëjtë, ndryshon vetëm formati. Pasi teksti transkriptohet, versioni në Brail krijohet përmes një procesi të quajtur “shtypje me sistem pikëzimi”, ku pika të ngritura shtypen në letër për të mundësuar leximin taktil. Njerëzit e verbër mund t’i ndjejnë me gishta për t’i lexuar këto pika të ngritura në letër, të cilat formojnë simbolet e Brailit.

Deklarimi ose fshehja e aftësisë së kufizuar

Deklarim ose **mosdeklarim** (em.) - E drejta që gëzojnë personat me aftësi të kufizuara për të treguar, ose jo, informacionin në lidhje me statusin e tyre të aftësisë së kufizuar. Në vendin e punës, duhet të largohemi nga termat tradicionale të «zbulimit» ose «deklarimit» të aftësisë së kufizuar, pasi mund të krijojnë përshtypjen se personi është duke zbuluar një sekret.

Fraza që përdorin shpesh punëdhënësit, “të identifikohesh si një person me aftësi të kufizuar” duhet shmangur, pasi është diskrimuese për identitetin e personave me aftësi të kufizuara. Disa mund të kenë një aftësi të kufizuar, por ende nuk e shohin veten si një person të tillë. Ose në shumë raste, karakteri i aftësisë së tyre të kufizuar nuk i pengon për të kryer një punë të caktuar.

Në vend që të përdoren terma, si: “zbulo aftësinë tënde të kufizuar”, ose “deklaro gjendjen tënde”, në komunikimet me personat me aftësi të kufizuara, drejtuesit e institucioneve ose të kompanive duhet të përdorin frazën: «zgjidhni nëse dëshironi të ndani informacion mbi aftësinë e kufizuar”. Kjo qasje shmang ndjesinë që punonjësi po zbulon një sekret personal në mënyrë të detyruar. Punonjësi mund të zgjedhë të informojë drejtuesin e tij mbi kërkesën për akomodim të arsyeshëm ose jo, por gjithmonë këtë e bën me vullnetin e tij, pa u ndjerë i shtyrë, ose i stigmatizuar.

Dëmtim vs Aftësi e Kufizuar

Dëmtim (em.) - Ky term i referohet çdo humbjeje ose anomalie të strukturës biologjike, ose funksionit psikologjik, fiziologjik ose anatomik. Është një ndryshim në strukturën ose funksionimin e trupit, si humbja e një gjymtyre, dëmtim i shikimit, ose një gjendje psikologjike. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, dëmtimi përqendrohet te ajo që ndodh brenda trupit ose mendjes.

Aftësi e kufizuar (tf.) - Rrjedh nga ndërveprimi midis personave me një dëmtim të caktuar dhe vështirësive të mjedisit rrethues, vështirësi të cilat i pengojnë këto persona që të kenë akses të plotë në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.

Aftësia e kufizuar shkon përtej konceptit “dëmtim”, sepse ajo nënkupton momentin kur pengesat sociale dhe mjedisore e kufizojnë aftësinë e një personi për të marrë pjesë në aktivitetet e përditshme. Aftësia e kufizuar nuk lidhet me gjendjen e personit që e bart, por është një konstrukt social. Ajo tregon se mënyra sesi është ndërtuar shoqëria (përmes hapësirave fizike, politikave sociale ose qëndrimeve të njerëzve) mund të krijojë pengesa për personat me një dëmtim të caktuar, duke e penguar përfshirjen e tyre në shoqëri, në mënyrë të barabartë me të tjerët.

Duke qenë se këto terma kanë kuptime të ndryshme, ato nuk janë sinonimike dhe nuk mund të përdoren për të zëvendësuar njëra-tjetrën. “Dëmtimi” është një aspekt personal, që lidhet me gjendjen fizike ose psikike të një personi, ndërsa “aftësia e kufizuar” shkaktohet nga faktorët e jashtëm të mjedisit dhe shoqërisë. Për shembull, nëse një person ka humbur këmbën në një aksident automobilistik, do të thotë se ka pësuar një dëmtim fizik. Ky është një problem mjekësor ose biologjik që ndikon në trupin e tij. Por, nëse ky person nuk mund të ngjitet në një ndërtesë (shtëpi, shkollë, zyrë etj.) sepse ndërtesa nuk ka rampë ose ashensor, ai përballlet me një pamundësi, e cila ia kufizon aftësinë e tij për të mbërritur në destinacionin që dëshiron. Pra, në këtë rast, “aftësia e kufizuar” nuk vjen nga vetë dëmtimi, por vjen nga mjedisi (mungesa e aksesueshmërisë) që e pengon personin të përfshihet plotësisht në veprimtaritë shoqërore.

Dëmtim shikimi vs verbëri

Dëmtim shikimi (tf.) - Përfshin një gamë të gjerë situatash të humbjes së shikimit, duke filluar nga vështirësitë e lehta në shikim deri te verbëria e plotë.

Verbëria (em.) është vetëm një formë e dëmtimit të shikimit, që do të thotë se jo të gjithë ata që kanë dëmtim shikimi janë të verbër.

Kështu, këto terma nuk janë sinonime dhe nuk duhet të përdoren në mënyrë të ndërkëmbyeshme me njëra-tjetrën. Për shembull, një person me dëmtim të shikimit mund të jetë në gjendje të shohë objekte të mëdha ose të dallojë dritën, por nuk mund të shohë mjaftueshëm qartë për të lexuar ose për të ngarë makinën. Ndërsa dikush që është i verbër nuk ka fare shikim.

EJBËLLIZËM

Ejbëllizëm (em.) - rrjedh nga fjala *ableism* (ableism) e anglishtes. Trajtim i padrejtë ose qëndrim negativ ndaj personave me aftësi të kufizuara. E thënë ndryshe, ejbëllizmi i referohet diskriminimit që u bëhet personave me aftësi të kufizuara në favor të personave pa aftësi të kufizuara. Ky diskriminim mund të jetë i qëllimshëm ose i pavetëdijshëm, por është gjithmonë i bazuar në supozimet se njerëzit me aftësi të kufizuara nuk kanë rëndësi, kanë më pak vlera e aftësi dhe nuk mund ta menaxhojnë jetën e tyre si njerëzit e tjerë të shoqërisë.

GJUHA E SHENJAVE vs SHENJA NDËRKOMBËTARE

Gjuha e shenjave (tf.) - janë shenja unike dhe të ndryshme në mbarë botën. Gjuha e shenjave u mundëson personave me aftësi të kufizuara në dëgjim të komunikojnë mes tyre dhe me njerëz të tjerë. Për shembull, ekziston Gjuha e Shenjave Meksikane, Gjuha e Shenjave Lituanëze, etj. Disa vende, si për shembull Kanadaja, kanë më shumë se një gjuhë shenjash. Në këtë vend përdoren Gjuha e Shenjave Amerikane (ASL) dhe Gjuha e Shenjave të Kebekut (LSQ). Këto dy gjuhë janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Kur i referohemi këtyre gjuhëve specifike, është e rëndësishme të shkruajmë me shkronjë të madhe secilën fjalë në emrin e tyre.

Nuk ekziston një gjuhë e vetme ndërkombëtare e shenjave që përdoret globalisht. Megjithatë, ekziston një formë komunikimi, e quajtur "Shenja Ndërkombëtare".

Shenja Ndërkombëtare (tf.)- është një sistem shenjash që përdoret për të lehtësuar komunikimin ndërmjet njerëzve që përdorin gjuhë të ndryshme shenjash. Ajo nuk është një gjuhë e zhvilluar plotësisht si Gjuha e Shenjave Amerikane (ASL) ose Gjuha e Shenjave Britanike (BSL), por një metodë e thjeshtë dhe informale komunikimi që mbështetet në një seri shenjash dhe gjestesh të dakordësuara. Ky sistem përdoret shpesh në ngjarje dhe takime ndërkombëtare ku mblidhen pjesëmarrës nga vende të ndryshme. Për shembull, gjatë një konference globale për persona me aftësi të kufizuara në dëgjim, "Shenja Ndërkombëtare" u mundëson pjesëmarrësve të kuptojnë njëri-tjetrin, edhe pse gjuhët e tyre të shenjave janë të ndryshme.

GJUHË E THJESHTË

Gjuhë e Thjeshtë (tf.) (anglisht EASY READ) - Stili i shkrimit dhe i paraqitjes së informacionit në mënyrë të lehtë për t'u kuptuar, kryesisht hartohet për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, ose ata që kanë vështirësi në kuptimin e tekstit të shkruar.

Krijimi i një versioni "Gjuhë e Thjeshtë" të një dokumenti të zakonshëm quhet "adaptim", ose "përshtatje" dhe jo përkthim. Megjithatë, si çdo dokument tjetër, një dokument i përshtur në "Gjuhë e Thjeshtë" mund të përkthehet nga njëra gjuhë në një tjetër dhe në këtë rast kemi të bëjmë me përkthim dhe jo me përshtatje.

Integrim vs gjithëpërfshirje

Ekziston një dallim i rëndësishëm midis konceptit “integrim” dhe “gjithëpërfshirje”.

Integrimi (em.) - është procesi në të cilin një individ, si për shembull një person me aftësi të kufizuara, përpiqet të përshtatet dhe të integrohet në strukturat dhe normat ekzistuese të shoqërisë. Në këtë rast, është individ ai që duhet të bëjë përpjekje për t'u përshtatur me kërkesat e shoqërisë.

Gjithëpërfshirja (em.) - është një proces më i gjerë dhe më i thellë sesa integrimi. Ai i referohet ndryshimeve të mjediseve dhe komunitetit shoqëror në mënyrë që të përfshihen dhe të priten të gjithë individët, pa marrë parasysh aftësitë e tyre ose ndonjë faktor tjetër përjashtues. Të gjithë duhet të ndihen të mirëpritur dhe të çmuar, pavarësisht gjendjes së secilit. Kjo do të thotë të sigurosh që të gjithë njerëzit, përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara, të mund të marrin pjesë plotësisht në të tëra aspektet e jetës.

“Gjithëpërfshirja” synon krijimin e një ambienti që është i hapur dhe i përshtatshëm për të gjithë, duke shmangur pengesat dhe duke promovuar barazinë dhe respektin për diversitetin njerëzor.

Në kontekstin e personave me aftësi të kufizuara, termi “gjithëpërfshirje” ka një kuptim pozitiv, pasi nënkupton krijimin e mundësive për të gjithë në një shoqëri që pranon dhe respekton diversitetin. Në kontrast me të, termi “integrim” mund të ketë konotacione më negative, pasi shpesh nënkupton që individ duhet të përshtatet me një sistem që nuk është ndoshta i modeluar për nevojat e tij apo të saj. Pra, këto dy terma nuk janë sinonime dhe përdoren në kontekste të ndryshme për të përshkruar mënyra të ndryshme të përfshirjes dhe të përshtatjes në shoqëri.

Jetesa e Pavarur

Jetesa e Pavarur (tf.) - është tërësia e mundësive që ofron mjedisi rrethues, në mënyrë që individët me aftësi të kufizuara të kenë të gjithë mbështetjen që u nevojitet për të pasur kontroll të plotë mbi jetën e tyre, si dhe lirinë për të marrë vendime për çdo aspekt jetësor. Jetesë e pavarur nuk do të thotë të jetosh vetëm, por nënkupton “të jetosh i pavarur nga të tjerët”. Po ashtu, kjo nuk duhet të interpretohet vetëm si aftësia për të kryer aktivitete të përditshme vetë, pa ndihmën e të tjerëve, por shkon shumë më përtej, sepse duhet të interpretohet si liria për të zgjedhur dhe për të kontrolluar vetë gjithçka, në përputhje me respektin për dinjitetin dhe lirinë individuale. E thënë ndryshe, pavarësia, si një formë e lirisë personale, do të thotë që personi me aftësi të kufizuara nuk është i privuar nga mundësia e zgjedhjes dhe e kontrollit mbi stilin e tij të jetës, apo aktivitetet e përditshme.

Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për kërkesat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim, veshje, ushqimin, higjienën e kujdesin personal dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare dhe komunitare. Jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Disa prej këtyre shërbimeve janë: Asistenca Personale, mjetet ndihmëse, shërbimet e aksesueshmërisë (përfshirë transportin dhe përshtatjen e arsyeshme) dhe vendimmarrja e mbështetur.

Jetesa e pavarur është një mënyrë për të ruajtur dinjitetin dhe respektin për veten dhe për të mbështetur personat të ndihen të respektuar dhe të vlerësuar në shoqëri.

Kafshë shërbimi

Kafshë shërbimi (tf.) - janë kafshë të trajnuara posaçërisht për të kryer detyra të caktuara për personat me aftësi të kufizuara. Ato mund të kryejnë detyra të ndryshme, siç janë udhëzimi i personave me aftësi të kufizuara në shikimi, tërheqja e karrigeve me rrota, ose marrja e objekteve të rëna. Termi 'kafshë' preferohet në vend të termit "qen", në mënyrë që të mos kufizohet vetëm tek qentë, pasi shërbime të ngjashme ofrojnë disa kafshë të tjera. Për shembull, majmunët Kapuçin janë trajnuar për të ndihmuar njerëzit me aftësi të kufizuara fizike në kryerjen e detyrave të përditshme. Kafshë të tjera, si papagajt, ferretët dhe kuajt, gjithashtu mund të trajnohen, ose përdoren për mbështetje emocionale.

NDIHMË, MBËSHTETJE, ASISTENCË

Termit "Ndihmë", "Mbështetje" dhe "Asistencë" (em.) - kanë kuptime të ndryshme dhe nuk duhet të përdoren si sinonime të njëra-tjetrës.

Termi "Ndihmë" zakonisht nuk rekomandohet të përdoret, sepse mund të nënkuptojë se personat me aftësi të kufizuara janë të pafuqishëm dhe të varur prej të tjerëve.

"Mbështetje" dhe "asistencë" janë terma më të preferuar për t'u përdorur, sepse ofrojnë një qasje më respektuese dhe fuqizuese. Për shembull, mund të përdoren frazat: "Personat që kërkojnë asistencë" ose "Masat e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara", të cilat theksojnë përpjekjet për të ofruar mbështetjen e nevojshme, duke theksuar fuqizimin dhe përfshirjen.

Nevojat vs kërkesat

Ekspertët preferojnë të përdorin termin "kërkesa" në vend të "nevojave". Kjo është në përputhje me qasjen e të drejtave të njeriut që gëzojnë personat me aftësi të kufizuara.

Termi "nevoja" shpesh përçohet si një përjetësim i stereotipave që i paraqet individët me aftësi të kufizuara si të varur ose si një barrë, veçanërisht kur flitet për "nevojat për kujdes". Për shembull, shkollat duhet të sigurojnë materiale në sistemin Brajl për nxënësit me aftësi të kufizuara në shikim, jo thjesht sepse ata kanë nevojë për to, por sepse ata kanë të drejtën për një arsim cilësor dhe të barabartë me nxënësit e tjerë.

Organizatat E/për PersonavE/t me Aftësi të Kufizuara

Organizatat "e" personave me aftësi të kufizuara duhet të dallohen nga organizatat "për" persona me aftësi të kufizuara.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuara drejtohen dhe kontrollohen nga vetë personat me aftësi të kufizuara. Ato përfaqësojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të anëtarëve të tyre.

Nga ana tjetër, organizatat për persona me aftësi të kufizuara ofrojnë shërbime ose mbrojnë në emër të personave me aftësi të kufizuar, por nuk drejtohen dhe kontrollohen nga vetë ata persona.

Person me aftësi të kufizuarA

Rekomandohet përdorimi i gjuhës që vendos në qendër njeriun. Kjo nënkupton përdorimin e termit "person me aftësi të kufizuara", i cili është më i përshtatshëm për të përshkruar individët në një mënyrë që fokusohet në personin dhe jo në kufizimet e tij.

PAK (shkurtim i trajtës: Persona me Aftësi të Kufizuara)

Nuk duhet të përdoret kurrë shkurtesa “PAK” ose “pak” për t’iu referuar personave me aftësi të kufizuara. Për të ruajtur standardet e komunikimit dhe respektin ndaj këtyre individëve, është e rëndësishme të përdoren terma të plotë dhe të qartë, siç është për shembull termi: “person me aftësi të kufizuara”. Shkurtesa tingëllon më shumë si një etiketë dhe për këtë arsye është fyese për personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimet vs nëntitujt

Përshkrimet dhe nëntitujt nuk janë të njëjtë, edhe pse të dyja shfaqen si tekst në fund të ekranit dhe paraqesin informacion mbi fjalët që dëgjohen.

Përshkrimet (em.) janë krijuar për t’i ndihmuar personat me aftësi të kufizuara në dëgjim. Ato përfshijnë jo vetëm dialogun, por edhe elemente të tjera të rëndësishme, si: Zhurmat e sfondit (p.sh., zhurmat e natyrës, zhurmat e qytetit); Identifikimin e folësve (p.sh., kur një folës ndryshon); Përshkrimin e muzikës dhe efektet muzikore; Detaje të tjera që ndihmojnë në kuptimin e plotë të përmbajtjes vizuale dhe akustike.

Nëntitujt (em.), nga ana tjetër, janë të destinuar për shikuesit që dëgjojnë, por nuk e kuptojnë gjuhën në video – për shembull, në filma ose në video në një gjuhë të huaj. Nëntitujt përfshijnë vetëm dialogun dhe shpesh nuk japin informacion për zhurmat e sfondit, ose për llojin e muzikës.

Përshkrimet ndahen në dy lloje:

Përshkrimet e mbyllura: Këto mund të hiqen nga shikuesi nëse e dëshiron, dhe janë të aktivizueshme ose të çaktivizueshme sipas nevojës.

Përshkrimet e hapura: Këto janë të përfshira në video dhe nuk mund të hiqen ose të fiken. Ato janë të qëndrueshme dhe të dukshme për të gjithë ata që shikojnë videon.

Përshkrimet në kohë reale janë gjithashtu të disponueshme në takime të ndryshme, qoftë në distancë (p.sh., përmes platformave të videokonferencave) ose në vend (p.sh., në auditorë ose salla takimesh), duke ofruar një përkthim të menjëhershëm të fjalëve të folura.

Është e rëndësishme të kuptohet dhe të merren parasysh këto dallime kur përdoren termat “përshkrim” dhe “nëntitull”, për të siguruar që informacioni të ofrohet në formën e duhur të tekstit, në varësi të kërkesave të audiencës dhe të përmbajtjes së videos.

Vendimmarrje e mbështetur

Vendimmarrja e mbështetur (tf.) - është një sistem që ofron mundësi të ndryshme mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara, që të marrin vendime për jetën e tyre. Ky sistem i jep përparësi vullnetit dhe preferencave të individit dhe respekton të drejtat e njeriut. Ai duhet të sigurojë mbrojtjen e të gjitha të drejtave, duke përfshirë të drejtat për autonomi (si e drejta për mbështetje ligjore, e drejta për njohje të barabartë para ligjit, e drejta për të zgjedhur ku të jetosh, etj.) dhe të drejtat për liri nga abuzimi dhe keqtrajtimi (e drejta për jetë, e drejta për integritet fizik etj.). Për më tepër, sistemet e vendimmarrjes së mbështetur nuk duhet të ndërhyjnë në mënyrë të tepruar jetën e personave me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që regjimet e vendimmarrjes së mbështetur mund të kenë forma të ndryshme, të gjitha duhet të përmbushin disa kushte kyçe për të siguruar përputhshmërinë me nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Këto përfshijnë:

(a) Disponueshmëria për të gjithë: Vendimmarrja e mbështetur duhet të jetë e disponueshme për të gjithë. Niveli i nevojave për mbështetje, veçanërisht kur është i lartë, nuk duhet të jetë një pengesë për të marrë mbështetje në vendimmarrje.

(b) Vullneti dhe preferencat e personit: Të gjitha format e mbështetjes në ushtrimin e praktikës ligjore, duhet të bazohen në vullnetin dhe preferencat e personit, jo në atë që dikush mendon se është më mirë për ta.

(c) Mënyra e komunikimit: Mënyra si komunikon një person nuk duhet të jetë një pengesë për të marrë mbështetje në vendimmarrje, edhe nëse ky komunikim është jo-konvencional, ose kuptohet nga shumë pak njerëz.

(d) Njohja ligjore e personave mbështetës: Njohja ligjore e personave mbështetës që janë zgjedhur formalisht nga vetë personi me aftësi të kufizuara. Institucionet shtetërore kanë detyrimin të mbështesin në këtë drejtim, veçanërisht personat që janë të izoluar dhe nuk kanë mbështetje në komunitet. Ky proces duhet të përfshijë një mekanizëm për të verifikuar identitetin e personave mbështetës dhe një mekanizëm tjetër për të rregulluar veprimet e tyre nëse këto veprime nuk përputhen me vullnetin dhe preferencat e personit me aftësi të kufizuara.

(e) Kostoja e mbështetjes: Mbështetja duhet të ofrohet me kosto të ulët, ose pa kosto fare, për individët me aftësi të kufizuara. Mungesa e burimeve financiare nuk duhet të jetë pengesë për të marrë mbështetjen e duhur.

(f) Të drejtat e tjera themelore: Mbështetja në vendimmarrje nuk duhet të përdoret si formë për të kufizuar të drejtat e tjera themelore të individëve me aftësi të kufizuara, si e drejta për të votuar, për t'u martuar, për të krijuar një partneritet civil, për të krijuar një familje, për të dhënë pëlqimin për marrëdhënie intime e trajtime mjekësore dhe e drejta për liri.

(g) E drejta për të refuzuar mbështetjen: Personi duhet të ketë të drejtën të refuzojë mbështetje dhe të ndërpresë, ose të ndryshojë marrëdhënien e mbështetjes në çdo kohë.

(h) Mekanizmat mbrojtës: Duhet të krijohen mekanizma mbrojtës për të gjitha proceset që lidhen me aspektin ligjor. Qëllimi i këtyre mekanizmave është që të sigurohet respektimi i vullnetit dhe dëshirave të personit me aftësi të kufizuara.

(i) Identifikimi i nevojave për mbështetje: Ofrimi i mbështetjes për të ushtruar praktikën ligjore nuk duhet të varet nga vlerësime të kapacitetit mendor. Duhet të përdoren forma të reja identifikimi, qasje jodiskriminuese, për të vlerësuar nevojat për mbështetje sipas rasteve.

Shtojcë: Parime të përgjithshme mbi gjuhën që duhet përdorur me dhe për personat me aftësi të kufizuara

Për të shmangur format joetike të komunikimit me/mbi personat me aftësi të kufizuara, si në nivel formal, ashtu edhe informal, është e rëndësishme të keni parasysh disa udhëzime praktike, të cilat janë si vijon:

1. PËRDORNI GJUHËN QË VË NË QENDËR PERSONIN

Gjuha që vë në qendër personin është gjuha më e përshtatshme për t'iu referuar personave me aftësi të kufizuara. Kjo është gjithashtu gjuha e përdorur në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Qëllimi i kësaj gjuhe është të theksojë personin, jo aftësinë e kufizuar. Për shembull, nuk duhet thënë "autik", por është korrekte të thuhet "Person me autizëm", pra në këtë mënyrë nuk përqendrohet vëmendja subjektivisht, por vihet në dukje në formë objektive raporti i pamundësisë së një individi në raport me shoqërinë. Pra, përcaktimi bëhet duke përshkruar kushtet e personit dhe jo duke bërë përcaktime përmes drejtimit të fokusit te vetë individi. E njëjta logjikë ndiqet edhe për raste të tjera të aftësisë së kufizuar, si për shembull, "student me disleksi", "grua me aftësi të kufizuara intelektuale", dhe natyrisht, "person me aftësi të kufizuara". Kjo është forma për të mos rënë në stigmatizim.

2. SHMANGNI ETIKETIMET DHE STEREOTIPET

Aftësia e kufizuar është një pjesë e natyrshme e jetës dhe diversitetit njerëzor, jo diçka që duhet dramatizuar, ose bërë sensacion. Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të portretizohen si "raste frymëzimi" ose si "qenie mbinjerëzore" apo "superheronj". Një gjuhë e tillë nënkupton se është e pazakontë për personat me aftësi të kufizuara që të jenë të suksesshëm, produktivë dhe të jetojnë një jetë të lumtur dhe të përmbushur.

Përshkrimi i personave me aftësi të kufizuara si "trima", "guximtarë" ose si njerëz që kanë "kapërcyer" aftësinë e tyre të kufizuar duhet të shmanget. Personat me aftësi të kufizuar kanë të njëjtat talente dhe aftësi si të gjithë të tjerët.

Shmangni etiketimin e njerëzve dhe mos përmendni aftësinë e kufizuar të një personi përveç rasteve kur është e rëndësishme, veçanërisht në komunikimet e brendshme dhe email-et. Duhet të përqendroheni te aftësitë dhe kërkesat e një personi dhe të përmendni aftësinë e kufizuar vetëm kur kjo jep informacion të dobishëm. Për shembull, nëse po diskutoni për vlerësimin e cilësisë së dokumenteve me sistemin Brajl, mund të përmendni se kolegu juaj është një "përdorues i Brajlit" ose që "mund të lexojë Brajl" në vend që të thoni se është i verbër. Aftësia e kufizuar nuk është e rëndësishme; fakti i rëndësishëm është që ai person ka aftësitë e nevojshme për të kryer punën që ka marrë përsipër. Gjithmonë përdorni një gjuhë pozitive dhe fuqizuese.

Nga ana tjetër, aftësia e kufizuar nuk duhet të injorohet apo të bëhet e padukshme. Gjithmonë sigurohuni që aftësia e kufizuar të përfshihet në mënyrë të duhur në bisedat dhe në punën tuaj. Është e rëndësishme të diskutoni hapur dhe me respekt çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar dhe të vendosni përfshirjen e tyre si një përparësi kryesore. Për një kohë shumë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara kanë qenë të përjashtuar nga përfaqësimi dhe pjesëmarrja, dhe shpesh janë injoruar, neglizhuar ose lënë pas dore.

3. MOS PËRDORNI EUFEMIZMA

Disa shprehje kanë fituar popullaritet me kalimin e kohës si alternativa ndaj termave të papërshtatshëm. Megjithatë, shumë prej këtyre shprehjeve pasqyrojnë një ide të gabuar se aftësia e kufizuar duhet të zbutet, apo të përshkruhet me terma më të butë. Prandaj, nuk duhet të përdorim terma eufemik, të tipit: “me aftësi ndryshe”, “njerëz me të gjitha aftësitë”, “aftësi e veçantë” etj. Për shembull, shprehja “me aftësi ndryshe” është problematike sepse, siç vërejnë disa aktivistë, të gjithë ne kemi aftësi të ndryshme. Eufemizmat, në fakt, përfaqësojnë një mohim të realitetit dhe janë një mënyrë për të shmangur diskutimin e hapur për aftësinë e kufizuar. Termi «person me aftësi të kufizuara» është më neutral dhe më i saktë se “person me aftësi ndryshe”.

Gjithashtu, duhet shmangur edhe përdorimi i termit “special”, por edhe shprehjet “nevoja të veçanta” ose “ndihmë speciale”. Rekomandohet që të përdorni një gjuhë më neutrale dhe pozitive.

4. AFTËSIA E KUFIZUAR NUK ËSHTË SËMUNDJE OSE PROBLEM

Modeli mjekësor i aftësisë së kufizuar e sheh aftësinë e kufizuar si një gjendje shëndetësore që duhet të shërohet. Sipas këtij modeli, personat me aftësi të kufizuara shihen si pacientë. Në të njëjtën mënyrë, modeli i bamirësisë për aftësinë e kufizuar e trajton atë si një barrë, ose një “problem” që personat pa aftësi të kufizuar duhet të zgjidhin. Kjo qasje e përshkruan aftësinë e kufizuar si objekt të bamirësisë dhe të mëshirës, duke përjetësuar qëndrime dhe stereotipa negativë.

Personat me aftësi të kufizuara nuk duhet të quhen “pacientë”, përveç rasteve nëse janë nën kujdes mjekësor dhe vetëm në atë kontekst. Gjithashtu, duhet të shmangni etiketimin e personave me aftësi të kufizuara sipas diagnozave të tyre (për shembull, “disleksik”), pasi kjo pasqyron modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar. Në vend të kësaj, përdorni gjuhë që vendos personin në plan të parë (për shembull, “person me disleksi” ose “ka disleksi”).

Shprehje si “vuajnë nga”, “të prekur nga”, ose “të goditur nga” janë të papërshtatshme. Ato nënkuptojnë dhimbje të vazhdueshme dhe pafuqishmëri, duke përforcuar supozimin se personat me aftësi të kufizuara kanë një cilësi jete të dobët. Në vend të kësaj, mund të thoni thjesht që një person “ka [një aftësi të kufizuar]”.

5. PËRDORNI GJUHËN E PËRSHTATSHME NË KOMUNIKIMIN E FOLUR DHE TË SHKRUAR

Kur flisni me ose për persona me aftësi të kufizuara, përdorni të njëjtën gjuhë të përditshme që do të përdornit me këdo tjetër. Për shembull, t’i thuash një personi që përdor karrige me rrota: “le të shkojmë për një shëtitje” ose t’i shkruash një personi që nuk dëgjon “a e ke dëgjuar lajmin?” është plotësisht e pranueshme. Këto janë fraza që nuk ka nevojë të shmangen.

Megjithatë, disa fraza, edhe nëse përdoren rastësisht, ose si shaka, mund të jenë fyese. Për shembull, të thuash që dikush është “i verbër si lakuriqi” ose “i shurdhër si shtylla” është fyese sepse këto fraza përforcojnë stereotipe. Edhe në biseda joformale ose të relaksuara, është e rëndësishme të mos përdoren shprehje të tilla.

Metafora të tipit: “i verbër ndaj kritikave”, ose “të biesh në vesh të shurdhër” mund të jenë gjithashtu të gabuara. Edhe pse këto fraza përdoren gjerësisht, ato mund të sugjerojnë në mënyrë të pavetëdijshme se të qenit i verbër ose i shurdhër është diçka negative. Është më mirë të gjeni mënyra alternative për të shprehur këto ide.

Po ashtu, përdorimi i termave mjekësore si “Alzheimer” ose “paranojak” për të përshkruar harresën e përditshme ose dyshimin mund të jetë fyese. Këto terma i referohen kushteve serioze dhe përdorimi i tyre në mënyrë rastësore mund të minimizojë sfidat me të cilat përballen personat që jetojnë me këto kushte.

Mesazhi i përgjithshëm është të përdorni një gjuhë që është respektuese për mënyrën se si mund të ndikojë te të tjerët, veçanërisht te personat me aftësi të kufizuara. Shmangni frazat që mund të ofendojnë në mënyrë të pavetëdijshme ose të përforcojnë stereotipe negative, dhe zgjidhni fjalë që respektojnë dinjitetin e të gjithë individëve.

Tabelë përmbledhëse e terminologjisë së rekomanduar dhe terminologjisë së gabuar

Ju lutem, vini re se termat që ndodhen në të njëjtën kuti nuk duhet të merren si sinonime. Ato janë grupuar sipas kategorive përkatëse.

GJUHA E REKOMANDUAR



- ✓ Person me aftësi të kufizuara;
- ✓ Person me [llojin konkret të aftësisë së kufizuar] (Për shembull, person me aftësi të kufizuara intelektuale)
- ✓ Njerëz me aftësi të kufizuara (vetëm në materiale që përshtaten me “gjuhë të thjeshtë”, në tekste informale dhe në gjuhën e folur)

- ✓ Person pa aftësi të kufizuara
- ✓ Pjesa tjetër e popullsisë

- ✓ Ka [aftësi të kufizuara/dëmtim/gjendje]

- ✓ Person me aftësi të kufizuara intelektuale

GJUHA QË DUHET TË SHMANGET



- ✗ Person me aftësi të veçanta
- ✗ Person me aftësi ndryshe
- ✗ Person i pamundur
- ✗ Handikapat
- ✗ Person me të gjitha aftësitë
- ✗ Person që jeton me aftësi të kufizuara

- ✗ Normal
- ✗ I/e shëndetshme
- ✗ Me aftësi të plota
- ✗ Me trup/mendje të shëndoshë

- ✗ Vuaj nga
- ✗ I/e prekur nga
- ✗ I/e goditur nga
- ✗ I/e shqetësuar nga

- ✗ I/e prapambetur
- ✗ I/e ngadalshëm
- ✗ I/e prekur
- ✗ I/e dëmtuar në tru
- ✗ I/e sfiduar intelektualisht
- ✗ Nën-normale
- ✗ I/e paaftë mendërisht
- ✗ I/e dobët në mendje
- ✗ Handikapat

GJUHA E REKOMANDUAR



✓ Person me aftësi të kufizuara psikosociale

✓ Person me aftësi të kufizuara në dëgjim
✓ Person me humbje të dëgjimit
✓ Person që ka dëgjim të dobët

✓ Person i/e verbër
✓ Person që është i/e verbër
✓ Person me aftësi të kufizuara në shikim
✓ Person me shikim të dobët

✓ Person me aftësi të kufizuara fizike
✓ Përdorues i karriges me rrota
✓ Person që përdor një karrige me rrota
✓ Person me aftësi të kufizuara në lëvizje

✓ Person me shtat të shkurtër

✓ Person me sindromën Doun

✓ Person me albinizëm (Albinizmi është një gjendje gjenetike e karakterizuar nga mungesa e melaninës, pigmentit që jep ngjyrë lëkurës, flokëve dhe syve. Kjo sjell si rezultat ngjyrën shumë të bardhë të lëkurës dhe flokëve dhe shpesh shkakton probleme me shikimin.

GJUHA QË DUHET TË SHMANGET



✗ I/e çmendur
✗ "I/e sëmurë mendërisht"
✗ Maniak
✗ Psikopat
✗ I/e panikosur

✗ Shurdh
✗ Personat me dëmtim të dëgjimit
✗ Shurdhër dhe memec
✗ Shurdh dhe qorr

✗ Verbëri
✗ Person me shikim të pjesshëm

✗ I/e paralizuar
✗ invalid
✗ I/e deformuar
✗ I/e çalë
✗ Person me kufizime fizike
✗ I dënuar të rrijë në një karrige
✗ I/e varur nga karrigia me rrota

✗ Xhuxh

✗ Daun
✗ Mongoloid
✗ Person i veçantë

✗ albino

GJUHA E REKOMANDUAR



- ✓ Person që përdor një pajisje për komunikim
- ✓ Person që përdor një metodë alternative komunikimi

- ✓ Parkim i aksesueshëm
- ✓ Parkim i rezervuar për persona me aftësi të kufizuara
- ✓ Tualet i aksesueshëm

GJUHA QË DUHET TË SHMANGET



- ✗ Jo-verbal
- ✗ Nuk mund të flasë

- ✗ Parkim për personat me mangësi
- ✗ Tualet për handikapatët

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, një sugjerim përgjithësues mbi terminologjinë e saktë që duhet përdorur gjatë komunikimeve është që të vihet theksi te përshkrimi i kushteve, në të cilat ndodhet një person. Për shembull, nuk duhet thënë “i prapambetur”, por është korrekte të thuhet “Person me aftësi të kufizuara intelektuale”. Pra, përcaktimi bëhet duke përshkruar kushtet e personit dhe jo duke bërë përcaktime përmes drejtimit të fokusit te vetë individi. E njëjta logjikë ndiqet edhe për raste të tjera të aftësisë së kufizuar.

Po ashtu, përdorni gjithmonë termat e duhur si: “karrige me rrota” dhe jo “karrige” apo “karrocë”. Karrigia me rrota është mjet lëvizshmërie, çlirimi, pavarësie që ndihmon, nuk kufizon. Për këtë arsye, është e palogjikshme në pikëpamjen gjuhësore që të thuhet: “i dënuar apo i gozhduar në një karrige me rrota”. Përdorimi i terminologjisë së duhur ndikon në nivelin e komunikimit në mënyrë profesionale dhe në atmosferën e ndërsjelltë të respektit me personin që keni përballë.

Ky botim u prodhuan me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkimi Evropian është një bashkim ekonomik dhe politik i 27 vendeve evropiane. Ai bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai vepron globalisht për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive, mjedisit dhe ekonomive, në mënyrë që të gjithë të mund të përfitojnë.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës